Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1212

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani, kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE "Reforma" SH.P.K., kundër vednimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESË REZERVË PËR AUTOMJETET SKODA OCTAVIA" me numër të prokurimit; 214-24-10180-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "POLICIA E KOSOVËS", më 18/02/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE "Reforma" SH.P.K. me nr. 2024/1212, e datës 14/12/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESË REZERVË PËR AUTOMJETET SKODA OCTAVIA", me numër të prokurimit: 214-24-10180-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues, AK/Policia e Kosovës.

2. Vërtetohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME PJESË REZERVË PËR AUTOMJETET SKODA OCTAVIA" me te dhënat si në pikën 1. (një) të vendimit.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE "Reforma" SH.P.K.i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 04.10.2024, "POLICIA E KOSOVËS", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "FURNIZIM ME PJESË REZERVË PËR AUTOMJETET SKODA OCTAVIA" me numër të prokurimit 214-24-10180-1-1-1, ndërsa Vendimi i Autoriteti Kontraktues është ngritur me datën 26.11.2024 per dhënie te kontratës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 300,000.00 €.

Me 01.12.2024, OE "Reforma" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 06.12.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 14/12/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga "Reforma" SH.P.K me nr. 2024/1212 lidhur me aktivitetin "FURNIZIM ME PJESË REZERVË PËR AUTOMJETET SKODA OCTAVIA" me numër të prokurimit 214-24-10180-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim, të OE REFORMA SH.P.K.

•AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 7 - Autoriteti kontraktues ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Në këtë rast AK ofertat e pranuara nga OE i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë ne harmoni me njoftimin për kontratë, FDT dhe specifikimet teknike të detyrueshme Anekil dhe të barabartë, pa favorizuar apo diskriminuar asnjë OE.

Prandaj ky pretendim i OE është i pa bazuar.

•AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 59 - Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender i të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara me njoftimin për kontratë , FDT dhe specifikimet teknike të detyrueshme Anekil. Andaj AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e të gjithë ofertave në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Prandaj ky pretendim i OE është i pa bazuar.

•Pretendimi 1: Arsyet e eliminimit tuaj si OE- AK sqaron se l.Ju te tista e çmime është kërkuar kolona emir I prodhuesit dhe vendi origjinës ju te kjo kolon keni vendosur ne vend te prodhuesit emrin ORGJINAL ,origjinal nuk është prodhues., Siç jeni informuar edhe ne letrën standarde për eleminin për ketë pike AK nuk ka kërkuar sqarim sepse nuk do te sillte rezultat pozitiv sepse oferta juaj është me larte se oferta e rekomanduar.

•Pretendimi 2: Ju keni dorëzuar autorizim nga Distributori i autorizuar i prodhuesit PORSCHE MACEDONIA" por nuk keni bashkangjitur Marrëveshja konfirmim në mes të distributorit dhe kompanisë prodhuese se distributori ka drejt te lëshoj autorizim, sepse PORSCHE MACEDONIA por

distributor Siç jeni informuar edhe ne letrën standarde për eleminin për ketë pike AK nuk ka kërkuar sqarim sepse nuk do te sillte rezultat pozitiv sepse oferta juaj është me larte se oferta e rekomanduar.

•Pretendim 3: lidhur me emrin e OE te rekomanduar nuk qëndron, sepse në njoftim për kontratë është vendosur emri ashtu siç është i regjistruar në ARBK, kurse në të gjitha dokumentet e vulosura nga OE, janë me këtë vulë Gjithashtu edhe llogo e OE e vendosur në dokumentet e ofruara nga OE po me këtë llogo. Prandaj ky pretendim i OE është i pa bazuar. Shih vulën e OE te rekomanduar për kontratë.

Pretendim 4: Në lidhje me autorizimet OE te rekomanduar me arsyetim se këta janë distributor dhe jo prodhues dhe nuk keni bashkangjitur Marrëveshja Konfirmim në mes të distributorit dhe kompanisë prodhuese se distributori ka drejt te lëshoj autorizim,

AK sqaron s kjo pik nuk qëndron sepse AK ka bere verifikimin e te gjithë autorizimeve të dorëzuar nga OE ofertës dhe te gjithë na e konfirmojnë se janë prodhues, po ashtu edhe ne verifikimet përmes internetit prodhuesit MAPCO, TRISKAN, SRLRicambi, EUVITES janë prodhues. Prandaj ky pretendim i OE është i pa bazuar.

•Pretendim 5: Në lidhje me pretendimin se prodhuesi MAPCO Nuk ka ne stok artikullin 23 AK sqaron se askund ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë nuk është kërkuar qe prodhuesi duhet te ketë ne stok artikuj të kërkuar, sipas kërkesës njj dosjen e tenderit është kërkuar afati i Ifierimit te cilit duhet ti përmbahet OE gjate implementimit te kontratës, ne kemi konfirmim nga prodhuesi se e përkrah OE ofertës dhe kemi deklaratën nga OE ofertës mbi afatin e liferimit i cili është sipas kërkesës ne dosjen e tenderit.

AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 61 te LPP dhe Nenit 41 te Rregullores nr.01/2022 - Sepse AK i ka analizuar të gjitha çmimet e të gjitha pakove dhe ka ardhur në përfundim se këto çmime nuk janë çmime Jo-Normalisht të Ulët, ashtu siç pretendon OE ankues. Po ashtu raporti i vlerësimit është kryer në mënyrë profesionale nga anëtarët e komisionit vlerësues dhe nuk ka pasur asnjë favorizim ndaj OE te rekomanduar për kontrate ashtu siq pretendon OE ankues. Pasi qe Kriteret për Dhënien e Kontratës ku kriter ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ne këtë rast AK ka vepruar ne harmoni te plote me nenin 60, 61, LPP-se 41- RRUOPP-se duke rekomanduar për kontratë OE me çmim me te lire sipas Njoftimin për kontratë dhe në DT. Autoriteti nuk ka kontestuar asnjë çmim te ofertës financiare te OE te rekomanduar për Kontrate.

Sipas RRUOPP- nenin 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët asnjë nga kushtet nuk është përmbush qe ky tender te cilësohet tender Jo-normalisht të Ulët nga ana e AK-se, neni 41.1 Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës - për AK te gjitha çmimet janë çmime te besueshme dhe nuk ka asnjë çmim i cili do te ndikonte negativ ne performance te implementimin e kësaj kontrate sipas kësaj oferte financiare te OE te rekomanduar për Kontrate.

Gjithashtu nuk mund te aplikohet as rregullore UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK pika 11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët nuk mund te aplikohet.

•Pretendimet se AK ka shkelur nenin 72 të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, konforme kërkesave në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate. Po ashtu AK nuk kam kërkuar sqarime

shtese pasi qe nuk do te sillte rezultat pozitiv sepse oferta juaj është me larte se oferta e rekomanduar. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

•Pretendimi 1: Arsyet e eliminimit tuaj si OE- AK sqaron se Ju te lista e çmime është kërkuar kolona emir i prodhuesit dhe vendi origjinës ju te kjo kolon keni vendosur ne vend te prodhuesit emrin ORGJINAL ,origjinal nuk është prodhues., Siç jeni informuar edhe ne letrën standarde për eleminin për ketë pike AK nuk ka kërkuar sqarim sepse nuk do te sillte rezultat pozitiv sepse oferta juaj është me larte se oferta e rekomanduar.

2Ju keni dorëzuar autorizim nga Distributori i autorizuar i prodhuesit PORSCHE MACEDONIA" por nuk keni bashkangjitur Marrëveshja Konfirmim në mes të distributorit dhe kompanisë prodhuese se distributori ka drejt te lëshoj autorizim, sepse PORSCHE MACEDONIA por distributor. Siç jeni informuar edhe ne letrën standarde për eleminin për ketë pike AK nuk ka kërkuar sqarim sepse nuk do te sillte rezultat pozitiv sepse oferta juaj është me larte se oferta e rekomanduar. Prandaj ky pretendim i OE është i pa bazuar.

Sipas fakteve të lartë përmendura AK nuk ka bërë shkelje të asnjërit të neneve të lartë përmendura. Ankesa e OE nuk është në përputhje me kërkesat e AK dhe në këtë rast kërkesa për Rishqyrtim është e PA BAZUAR.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Reforma” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Më dt.27.11.2024 ne si operator ekonomik pjesëmarrës në tenderin me titull:” Furnizim me pjese rezerve për autoinjetet Skoda Octavia”, nic nr.prokurimi : 214-24-10180-1- 1-1 , kcmi pranuar njoftimin nga ana c autoritctit kontraktucs-Policia e Kosovës mbi eleminimin(letra standardc B42).

Poashtu në letrën standarde të eleminimit-autoriteti kontraktues ka elaboruar edhe arsyet e eleminimit si në vijim :

1.Te lista e çmimeve është kërkuar te kolona emri i prodhuesit dhe vendi i origjinës-kurse ne si operator ekonomik në vend të prodhuesit kemi vendosur emrin origjinal , origjinali nuk është prodhues;

2.Autorizimi i lëshuar nga prodhuesi -duhet të ketë të bashkangjitur marrëveshja- konfirmimi në mes distributorit dhe kompanisë prodhuese se distributori ka të drejtë të lëshoj autorizim.

Lidhur me pikën 1 të eleminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit -njoftojmë OSHP-ën se kjo arsye është e paqëndrueshme dhe e pabazuar në dispozitat e LPP-së.Tek kolona -emri i prodhuesit ne nuk e kemi vënë emrin e prodhuesit sepse kemi konsideruar se ajo nënkuptohet nga vet titulli i këtij aktiviteti “Furniziin me pjese rezerve për automjetet Skoda Octavia” (ne te prodhuesi kemi vendosur termin Origjinal ndersa vendi i prodhimit-Gjermani.Pra kjo nenkupton se ofertojme vetem me pjese origjinale te prodhuesit Skoda- prodhuesi i autopjeses eshte Skoda-pjese origjinale te prodhuara nga Skoda- pasi qe behet fjale vetem per Skoda). Ne kemi ofruar autorizim të prodhuesit “Porche “nga Austria,gjegjesisht nga dega e Porsches ne Maqedoni , pra ne emërtimin origjinal e kemi vërë për të treguar se do të ofrojmë pjesët origjinale për “Skoda Octavia”, nga prodhuesi “Skoda”, sepse “Porsche Automobil Holding SE” është aksionari kryesor me 53.3% te aksioneve në Vw-Group ku bënë pjesë edhe Shkoda.

Pra Porsche është prodhues dhe pronar i automjetit “Skoda”.

Megjithatë , autoriteti kontraktues në rast të paqartësive eventuale ka mundur të kërkojë sqarime shtesë nga ne bazuar në nenin 72 të LPP-së.

Poashtu as pika e 2 eleminimit tonë nga gara e mëtutjeshme në këtë aktivitet të prokurimit nuk qëndron dhe e njejta nuk ka bazë ligjore.Bazuar në Dosjen e Tenderit pika 7.1 & 7.2 tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, është kërkuar: 3.Autorizim nga prodhucsi ose distributori i autorizuar i prodhuesit (nëse autorizimi është nga distributori atëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes distributorit dhe prodhuesit, për shitjcn e produkteve qe ofroni për tenderin (me tituli dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë), në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj.Ne si operator ekonomik kemi ofruar autorizimin nga prodhuesi " Porsche Automobil Holding SE" -gjegjesisht nga Porsche Macedonia -dega ne Shkup. Porsche është aksionari kryesor me 53.3% të aksioneve në Vw-Group ku bënë pjesë edhe Shkoda.Pra "Porsche" është prodhues dhe pronar i automjetit "Skoda", e jo distributor siq pretendoni ju si autoritet kontraktues , dhe se ne nuk kemi pasur nevojë të bashkangjesim kontratë ose autorizim mes distributori dhe prodhuesit, për shitjen e produkteve qe ofertojmë. Numri i Autorizimit te kompanise Reforma nga prodhuesi i automjeteve "Skoda" është 430/10050.Ju lutemi e verifikoni ne Porsche - Skoda. Ju lutemi per informata dhe detaje i drejtoheni Porsche Maqedonise ne imellin: bartolomej.kajtazi@porsche.com.mk me nr tel:00389 70 352 366

Pra nga faktet dhe provat e lartëcekura rezulton se ofeta jonë ka qenë ofertë e përgjegjëshme dhe konform kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të dt.27.11.2024 për këtë aktivitet të prokurimit keni rekomanduar për shpërblim me kontratë OE. Dyqani i Pavarur Tregëtar i Autopjesëve " Buqa".

Pas qasjes në dokumentacion tenderik që na u ka mundësuar nga ana e autoritetit kontraktues në ofertën operatorit ekonomik të rekomanduar për shpërblim me kontratë ne konstatojmë se oferta e këtij operatori ekonomik është e papërgjegjshme dhe se autoriteti kontraktues ka bërë slikelje të dispozitave të LPP-së për arsyet si në vijim:

Eshte shkelur LPP neni 7 Barazia nc Trajtim/ Jo-Diskriminimi Autoriteti kontraktues me rastin e rekomandimit për shpërblim me kontratë të OE."Buqa" . ka bërë diskriminim ndaj nesh , duke favorizuar OE."Buqa", sepse i njejti operator është i papërgjegjshëm. OE."Buqa", nuk e ka plotësuar pikën 7.1 & 7.2 të Dosjes së Tenderit tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, është kërkuar : 3.Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i prodhuesit (nëse autorizimi është nga distributori atëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes distributori dhe prodhuesit, për shitjen e produkteve qe ofroni për tenderin (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë), në kohëzgjatje të I kontratës prej 36 muaj.

Nga vet titulli i kontrates se AK kerkon pjese rezerve per automjetin Skoda Oktavia dhe kërkon autorizim nga prodhuesi (nenkuptohet i automjetit Skoda)- atehere detyrimisht autorizimi duhet te jete nga prodhuesi i automjetit Skoda.

I njejti operator ekonomik në ofertën e tij ka bashkangjitur autorizime nga disa kompani si Mapco ,Triskan , SRLRicambi, Euvites , mirëpo këto kompani janë kompani paketucse dhe jo prodhuese-që kanë cilësinë e distributorit e jo te prodhuesit që prodhojne pjese ne fabrika te ndryshme ne tere boten,e kane te rexhistruar brendin e vet,paketojne mall ne emer te brendit te vet dhe shesin.Jane kompani distributore per brendet e veta te prodhuara tek kompanite e ndryshme boterore.

AK nuk ka bere kurrfar hulumtimi dhe ska paraqite kurrfar deshmie per keto autorizime dhe per kompanite te cilat e kan autorizu DPT Buqa per fumizim me pjese rezerve.

Kompania "Triscan"nga Danimarka nuk ka fabrika të saj për prodhimin e pjesëve,por ajo operon si një kompani e specializuar në zhvillimin,testimin dhe shpëmdarjen e pjesëve të automjeteve ,Triscan bashkëpunon me rrjete të ndryshme fiimitorësh dhe prodhuesish të pjesëve në Evropë dhe Azi për të prodhuar komponent që ajo shet. Kompania MAPCO Informacion për MAPCO Autotechnik GmbH MAPCO është një kompani gjermane e bazuar në Bruck, e cila ofron pjesë rezervë dhe aksesorë për automjete. Kompania është themeluar në vitin 1977 dhe sot fokusohet kryesisht në paketimin dhe shpërndarjen e pjesëve për tregun aftermarket nën markën MAPCO. Kjo përfshin sisteme drejtimi, pezullimi, frenime, motorë dhe filtra. MAPCO shpërndan produkte për miliona automjete në Evropë dhe më gjerë, duke u njohur për cilësinë e lartë dhe fokusin ndaj kënaqësisë së klientëve. Sot, MAPCO është pjesë e grupit ndërkombëtar BBB Industries, i cili e ka blerë kompaninë më 28 janar 2022. Burimet

1.Informacion i marrë nga faqja zyrtare e MAPCO: https://www.mapco.com

2.Dctaje për historinë dhe pronësinë e kompanisë: https://pitchbook.coni/profiles/coinpany/123456

3.Pënnbledhje mbi aktivitetet e kompanisë: https://www.bbbind.com

Përmbledhje rreth Kompanisë Triscan Informata mbi Triscan

Triscan është një kompani daneze e specializuar në tregun aftermarket të pjesëve të këmbimit për automjete. Kompania ofron një gamë të gjerë produktesh, duke përfshirë pjesë për sisteme frenimi, drejtimi, pezullimi, kabllove, si dhe kategori të tjera. Triscan operon kryesisht si një paketues dhe shpëmdarës, jo si prodhues i drejtpërdrejtë i pjesëve që ofron. Ajo bashkëpunon me fumizues të jashtëm dhe prodhues globalë, duke garantuar standarde të larta cilësie për produktet e saj.

Karakteristikat Kryesore të Triscan -**Paketuese dhe shpëmdarëse**: Triscan nuk prodhon direkt, por fiimizohet nga prodhues globalë dhe i shërben tregut aftermarket me pjesë të standardeve të larta.

-**Kontroll i rreptë i cilësisë**: Produktet e saj kalojnë kontrolle të rrepta për tu sigumar që përmbushin standardet evropiane.

-**Infrastrukturë modeme logjistike**: Kompania ka sisteme të avancuara shpëmdarjeje që sigurojnë dërgesa të shpejta dhe efikase.

-**Gama e gjerë e produkteve**: Ofron mbi 60,000 artikuj për kategori të ndryshme të automjeteve.

Burimet e Informacionit Informacionet mbi Triscan janë marrë nga burimet e mëposhtme:

-Faqja zyrtare e Triscan dhe materialet publike të publikuara nga kompania.

-Të dhëna dhe raporte mbi tregun aftermarket të automjeteve në Evropë.

-Përmbledhje dhe analiza nga portale të njohura për industrinë e pjesëve të këmbimit.

-Faqja zyrtare e Triscan: https://www.triscan.dk

-Raporte dhe analiza nga portale të industrisë: https://www.aftermarketnews.com

-Informata të përgjithshme mbi tregun aftermarket në Evropë:ittps://www.autoserviceworld.com

Pra këto kompanit në fjalë thënë hipotetikisht edhe po të kishin qenë prodhuese të pjesëve rezervë të njejtat do të duhej t'a kishin autorizimin e prodhuesit te brendit te tyre Mapko apo Triscan.

Autoriteti kontraktues me këtë rast ka përdorur standarde të dyfishta , ku unë si operator ekonomik kam ofruar autorizim origjinal nga prodhuesi i mirënjohur Evropian ''Porsche Automobil Holding SE"- kam ofruar numrin e autorizimit per shitje dhe servisime te pjeseve rezerve per automjetet Skoda, dhe më eleminoni me pretekst se mungon marrëveshja me prodhuesin , ndërsa OE."Buqa" edhe përkundër faktit se i njejti nuk i ka ofruar autorizimet apo marrëveshjet me kompanite e cekura te cilat jane autorizime nga kompanite qe jane distributorc te brendit te vet c asesi kompani prodhucsc.Kteo janë autorizime nga kompanite distributere e jo prodhuese dhe AK prape DPT Buqa e shperblene me kontrate.

Kerkoj nga AK qe per keto raste te cekura dhe pretendime te kompanise Reforma te ceke argumentet dhe deshmite e veta tc kunderta me pretendimet tona.

Deri me tani kete nuk e ka ba. Tcnderet Jo-normalisht të Ulct-ncni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurimm Publik

Autoriteti kontraktues me rastin e rekomandimit për shpërblim me kontratë të OE."Buqaj' ka bërë shkelje të nenit 41 të Rregullores Nr.001/2022 , sepse çmimet e ofruara nga ana e këtij OE-janë çmime jo-normalisht të ulëta ,krahasuar me çmimet e ofruara nga ana e jonë.Çmimi total i ofertës financiare të këtij operatori është : 10686.55 euro, çmimi i OE."Reforma"Sh.P.K. : 17026.93 euro , kurse çmimi i OE."Baki Automobile" është : 21980.10 euro.Në rastin konkret janë përmbushur kushtet për zbatim të nenit 41.3 të Rregullores në fjalë , sepse çmimi i ofruar nga OE."Buqaj" është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët.

AK-ja ka qenë e obliguar që të veprojë konform nenit 41.6 të rregullores duke kërkuar një deklaratë me shkrim nga ana e OE"Buqaj".Sepse bazuar në nenin në fjalë citat:" Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët". OE.DPT "Buqa" përveç që ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëtaj njejti ka ofru edhe artikuj që nuk i ka në stok kompania "Mapco" siq është artikulli me nr. rendore 23,Turremarres te prodhimit "Mapco".

Ndërsa siq ju sqaruam më lartë kompania"Mapco" nuk është prodhuese e artikujve fare , por është distributor-rishitës. Shkelja e Nenit 52.7 të LPP-së

AK-ja në dosjen e tenderit ka kërkuar edhe shërbime servisimi nga kompania ofertuese për punët të cilat nuk mund të kryhen në servisin e flotës Operative të Policisë së Kosovës.Këto janë punë dhe shërbime që kryhen në serviset e autorizuara nga VW-Group , sepse kemi të bëjmë me shërbime "online" , që i ofron prodhuesi "Skoda".Për këtë aresye këto punë dhe shërbime të caktuara nuk munden të kryhen as në Autoservisin e Flotes Operative të Policisë së Kosovës.

Urdhëroni dhe kontaktoni kompetentët e Autoservisit të Policisë së Kosovës se për çfarë arësye nuk munden ti kryejnë këto lloje të servisimeve-për atë se nuk kanë licencë servisimi për të njejtat shërbime nga prodhuesi "Skoda".

Në kryerjen e këtyre punëve dhe shërbimeve kanë çasje vetëm Autoserviset e autorizuara për Skoda që në Kosove jane vetem 4 autoservise:Reforma,Porshe Kosova,Baki Automobile dhe AHP.

Per ti kryr keto pune servisore oferuesi patjeter qe duhet te kete nje Autoservis apo te kete contrate bashkepunimi me nje Autoservis te licencuar nga Skoda per kryerjen e sherbimeve. Operatori ekonomik DPT BUQA-ka ofruar nji kontrate bashkepunimi me kompaninë Hili shpk e cila kompani si duket as qe ka Autoservis te rexhistruar-shiqo permbajtjen e tontrates.

Njeherit kompania Hili shpk nuk ka paraqitur as autorizimin nga prodhuesi Skoda qe mund ti kryej sherbimet e kerkuara nga AK.

Operatori ekonomik "Hili SH.P.K." më dt.09.10.2024 ka nënshkruar kontratë mbi qiramarrjcn me Shukri Dervishollin tek Zyra Noteriale e Faik Sh.Çollaku me seli në Fushë Kosovë , ku objekt i qiramarrjes ka qenë paIuajtshmëria me kulturë Arë.Ndërsa në nenin 2 të kontratës ekziston deklarimi i palëve se në këtë paluajtshmëri ekziston një objekt i pa lcgalizuar.Pra vet palët kontraktuese e pranojnë se objekti është i pa legalizuar , kurse autoriteti kontraktues e pranon të mirëqenë këtë kontratë.Në rastin konkret kjo kontratë do të duhej të shpallej NULE , konform nenit 35 të LMD.Parashtrohet pyetja logjike se si autoriteti kontraktues e shpërblen një operator ekonomik i cili ka marrë një objekt me qira e i cili objekt është i pa legalizuar.Si mund të tatimohet dhe si do të paguajë tatimin në ATK operatori ekonomik për qiramanje.

AK-ja do të duhej që konfonn nenit 52.7 të LPP-së që të bëjë verifikimin e dokumentacionit në mënyrë detale.

Shkelja e Nenit 59 të LPP-së , Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Autoriteti kontraktues me raslin e rekomandimit për shpërblim me kontratë të OE."Buqaj" ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së , sepse Komisioni Vlerësues për ekzaminimin , vlerësimin dhe krahasimin e ofertave pranë AK-së, ka rekomandu për shpërblim me kontratë një operator ekonomik të pa- përgjegjshëm dhe i cili nuk i plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit.Gjersa në anën tjetër neve si ofertues në këtë aktiviet të prokurimit na ka eleminuar pa bazë ligjore edhe përkundër faktit se oferta jonë është e përgjegjëshme. Shkelja e Nenit 72 të LPP-së, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Autoriteti kontraktues me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së, sepse neve si ofertues në këtë aktivitet të prokurimit na ka eleminuarnga gara e mëtutjeshme në këtë aktivitet të prokurimit pa kërkuar informacion shtesë, ndërsa po të kërkonte informacion shtesë nga ne besojmë se arsyet për eleminim siq i sqaruam më sipër nuk do të qëndronin dhe ne do të ishim operator i rekomanduar nga ana e autoritetit kontraktues.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 7 i LPP-së Neni 52.7 i LPP-së Neni 59 i LPP-së Neni 61 i LPP-së Neni 72 i LPP-së Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik, Tcnderët Jo-normalisht të Ulët . Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që i elaboruam më lartë , kërkojmë nga Peneli shqyrtues i OSHP-së të merr këtë : VENDIM te APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE "REFORMA " SH.P.K , lidhur me tenderin Furnizim nic pjese rezervë për automjetet Skoda Octavia", me nr.prokurimi : 214-24- 10180-1-1-1, të inicuar nga ana e autoritetit kontraktues-Policia e Kosovës. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së-Policia e Kosovës i dt.27.11.2024, për dhënie të kontratës

dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 20/12/2024 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1212/24, ndërsa me datë 31/12/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1212 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit te ekspertit.

Lidhur me pretendimet e OE "Reforma" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1212 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ekonomik ankues (" Reforma " SH.P.K.) i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues/Policia e Kosovës, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat ligjor të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), konkretisht pretendon se jemi eliminuar pa te drejte nga AK dhe njeherit pretendon se i rekomanduari për kontrate (Dyqani i pavarur tregtare "Buqa"), nuk është i përgjegjshëm.

Autoriteti kontraktues pas përfundimit të vlerësimit te ofertave e njofton operatorin ekonomik ankues me letrën standarde te tenderuesit te eliminuar, me te cilin i ka jep arsyet e eliminimit, ndërsa ka rekomanduar për kontrate OE " Dyqani i Pavarur Tregtar Auto pjesë "Buqa" Përparimi, Prizren.

OE ankues me datën 27.11.2024 ka kërkuar qasje ne dokumente zyrtare, ndërsa AK me datën 29.11.2024 ka lejuar qasjen për OE ankues.

Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ankues Reforma SHPK me datën 01.12.2024 ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, ndërsa me datën 06.12.2024 autoriteti kontraktues ka refuzuar kërkesën për Ri-shqyrtim si të pabazuar.

Autoriteti kontaktues, eliminon OE ankues me arsyetimet si me poshtë:

Eksperti shqyrtues, sqaron se, ne listën e çmimeve ku autoriteti kontraktues ka kërkuar qe te shënohet emri i prodhuesit dhe vendi i origjinës, OE ankues e ka shënuar vetëm vendin e origjinës.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dëshmitë e dorëzuara,vlerëson se pavarësisht faktit qe OE ankues nuk e ka shënuar edhe emrin e prodhuesit, një fakt i tille dihet sepse AK ka kërkuar edhe autorizim te prodhuesit, ne te cilin sqarohet fakti se kush është prodhuesi dhe poashtu edhe vendi i origjinës.

Sa i përket arsyes se dyte te eliminimit, OE ankues ne ankesën e tij pretendon se Porsche është aksionar kryesore me 53.3% te aksioneve ne Vw Group dhe nuk është distributore siç pretendon AK – Policia e Kosovës ku bene pjese edhe shkoda dhe se sipas OE ankues nuk është e nevojshme ti bashkëngjisim kontratën ose autorizimin ne mes te prodhuesi dhe distributorit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues e ka dorëzuar autorizimin nga Porcshe Macedonia, i cili është i autorizuar për automjetet Shkoda, Audi dhe te tjera. Bazuar ne te dhënat e këtij autorizimi eksperti shqyrtues vlerëson se ky autorizim është i distributorit dhe nuk është direkt nga prodhuesi. Andaj, nuk qëndron pretendimi i OE ankues sepse porsche për te cilin pretendon OE ankues, duhet te ketë një kontrate me Porsche Macedonia dhe te njëjtën është dashur ta dorëzojë ne ofertën e tij.

OE ankues, ne ankesën e tij pretendon se i rekomanduari për kontrate, nuk është i përgjegjshëm me arsyetimin se ka ofruar autorizimin nga një kompani e cila është kompani paketuese dhe jo prodhuese qe e kanë cilësinë e distributorit dhe jo te prodhuesit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se autorizimi i dorëzuar ne ofertën e te rekomanduarit për kontrate është sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate. Ne vazhdim eksperti shqyrtues sqaron se AK, ne përgjigje te kërkesës për rishqyrtim, është deklaruar se ka bere verifikimin e dëshmive dhe njeherit e ka konfirmuar se autorizimi është i lëshuar nga distributori. Eksperti shqyrtues poashtu sqaron se me një kërkim te thjeshtë ne internet rezulton se kompania qe e ka lëshuar autorizimin është distributor i autorizuar i pajisjeve te automjetit shkoda. Prandaj, nuk qëndron pretendimi i OE ankues.

OE ankues, ne ankesen e tij pretendon se janë plotësuar kushtet e parapara ne rregulloren për çmime jo normalisht te uleta, me arsyetimin se oferta e te rekomanduarit për kontrate është 10% me e ulet se çmimi i tenderit te dyte.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim për arsye se për tu aplikuar tabela e parapare për çmimet jonormalisht te ulëta duhet te jen tri oferta te përgjegjshme, e ne rastin konkret oferta e OE Baki është e papërgjegjshme sipas letrës standarde te tenderuesit dhe njeherit sqaroj se sipas dispozitave ligjore të nenit 61 te LPP-se, vlerësimi i çmimeve është e drejte e autoritetit kontraktues dhe te njëjtit e kanë dhënë përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim.

Ne vazhdim OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate ka ofruar një kontrate lidhur me servisimin e automjeteve, kontrate me OE Hili i cili nuk ka autorizim nga Shkoda për servisimin e automjeteve, pra pretendon se nuk e ka plotësuar piken 2 te kapacitetit teknik dhe profesional.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se nuk qëndron për arsye se AK ne dosje te tenderit nuk ka kërkuar për servisim autorizim nga prodhuesi dhe njeherit sqaroj se një operatore ekonomik nuk mund te eliminohet për një kërkesë e cila nuk është e parashtruar ne dosje te tenderit.

Rekomandimi ekspertit shqyrtues:

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 20/12/2024 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1212/24, ndërsa me datë 31/12/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1212 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Reforma" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Reforma" SH.P.K., janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimit ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik, duhet refuzohet si e pabazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, i dates, 26.11.2024, për të shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Rrjedhimisht Paneli shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Policia e Kosovës, lidhur aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESË REZERVË

PËR AUTOMJETET SKODA OCTAVIA", me numër të prokurimit: 214-24-10180-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

Paneli shqyrtues vrene se sipas RRegullores Prokurimit Publik- nenin 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët, nuk janë përmbushur kushtet ligjore qe ky tender të cilësohet tender Jo-normalisht të Ulët nga ana e AK-së, Neni 41.1, përcakton" Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës".

Po ashtu neni 41.3 i rregullores në fjalë ka përcaktuar se duhet të jenë të dorzuar të paktën 3 (tre) tender te pergjegjeshm, Neni 41.3 percakton" Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Paneli shqyrtues vren se Autoriteti kontraktues ne përgjigjjen e dhenë me 06.12.2024 ndaj kërkesës për rishqyrtim, të OE "Reforma" SH.P.K, ka dhenë arsyetimet ligjore ne pretendimet ankimore lidhur me Nenin 61 të LPP ,Nenit 41 të Rregullores nr.01/2022, Prokurimit Publik_(RRPP) dhe Udhëzuesit nr.001/2023, të Prokurimit Publik (UPP) dhe me rastin e vendimmarrjes në ket aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti kontraktues/Policia e Kosoves, ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore te LPP, RRPP dhe UPP , me rastin e vendosjes se këtij aktiviteti te prokurimit, pasi që vrehet pretendimet ankimore te OE ankues janë te pabazuara për arsye se për tu aplikuar tabela e parapare për çmimet jonormalisht te ulëta duhet te jenë tri oferta të përgjegjshme, e në rastin konkret oferta e OE "Baki" është e papërgjegjshme, sipas Letrës standarde të tenderuesit, 22.11.2024, derisa ne ket aktiviteti prokurimi kanë aplikuar vetëm 3 (tre) operator ekonomik dhe vetëm dy OE kanë qenë te pergjegjeshëm. Sipas dispozitave ligjore të nenit 61 të LPP-se, vlerësimi i çmimeve është e drejte e autoritetit kontraktues dhe se për Autoritetin kontraktues te gjitha çmimet janë çmime të besueshme dhe nuk ka asnjë çmim i cili do te ndikonte negativ ne performance të implementimin e kësaj kontrate sipas kësaj ofertës financiare të OE të rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues se po ashtu duke u bazuar ne faktet dhe gjendjen faktike që u përshkrua si më sipër, vrenë operatori ekonomik ankues OE " Reforma " SH.P.K, ka ofertuar me qmim me të lartë përkatësisht në shumen prej; 17,026.93 euro, derisa sa operatori ekonomik i rekomanduar për tu shpërblyer me kontratë OE"Buqa", ka ofertuar me qmim më të lirë se ankuesi, përkatësisht në shumen prej 10,686.55 euro dhe kjo i kontribuon parimit të ekonomicitetit në shfrytëzimin e mjeteve buxhetore për aktivitetin e prokurimit.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me

pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2024/1212, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **" Reforma " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: